



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

---

Numri i lëndës: 2022:041277  
Datë: 10.09.2024  
Numri i dokumentit: 06143841

**C.nr.665/2022**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil,** gjyqtari Baki Shigjeqi, me bashkëpunëtoresh profesionale A.Gj. duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditëses H.R. me numër personal ..... nga Prizreni, të cilën me autorizim e përfaqëson av.B.K. nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën me autorizim e përfaqëson V.I.Xh. me objekt të kontestit kompensimi i të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, vlera e kontestit 467.40 euro, jashtë seancës gjyqësore, më datë 10.09.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. RFUZHET si e pabazuar** kërkesëpadia e paditëses H.R. nga Prizreni, me të cilën ka kërkuar që : *“DETYROHET e paditura, që paditëses, në emër të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, për periudhën kohore prej datës 18.04.2017 deri më datë 23.04.2018 (për çdo muaj shumën prej 38.95 euro, në shkallë prej 19% të pagës 421.00 euro, në emër të diferencës së papaguar të kualifikimit ose licencimit), t’ia paguajë shumën prej 467.40 euro, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, nga dita e parashtrimit të padisë e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.”.*

**II.** Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

**A r s y e t i m**

Paditësja H.R. nga Prizreni, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson av.B.K. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate me datë 01.03.2022, ka parashtruar padi, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt të kontestit kompensimin e diferencës së pagës së kualifikimit të pa paguar.

Në padi, pala paditëse ka theksuar se paditësja është e punësuar si mësimdhënëse pranë SHFMU “Fadil Hisari” në Prizren. Meqenëse paditësja është e licencuar dhe e ka kualifikimin e mësimdhënësit me shkollë të lartë pedagogjike, në bazë të nenit 7 të kontratës kolektive të

datës 18.04.2017, të njëjtës i është garantuar e drejta në pagesën shtesë prej 19% të pagës bazë, çka e paditura këtë shtesë e paguan pjesërisht. Paditësja realizon pagën bazë prej 421 euro në muaj, ndërsa shtesën prej 19% e kësaj page apo shuma prej 79.99 euro e paditura ia paguan pjesërisht dhe atë në shumën prej 41.04 euro, duke i mbetur borxh shumën prej 38.95 euro, që nga data 18.04.2017 deri me datë 23.04.2018 dhe ka kërkuar nga gjykata që të aprovohet padia dhe kërkesëpadia e paditësit, të detyrohet e paditura që në emër të diferencës së pagesës shtesë për kualifikim të pa paguar në shumën prej 467.40 euro, me kamatë ligjore prej 8%.

E paditura, në përgjigjen në padi e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar, duke kërkuar që gjykata të njëjtën ta refuzoj si të pabazuar. Ka theksuar se në bazë të njoftimit të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit nr.01B/ të datës 21.11.2022, për shkëputjen e Kontratës Kolektive të Arsimit të datës 22.01.2021 padia dhe kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar. Më tej ka theksuar se pretendimi i paditësit se i takon kompensimi për licencim është në kundërshtim me nenin 2 par. 1.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit, sepse në atë dispozitë shkruan se përfitues të të gjitha beneficioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm për anëtarët e Sindikatës së Arsimit – SBASHK-ut, ndërsa paditësi nuk ka paraqitur fakte se është anëtar i kësaj sindikate, nuk ka dëshmuar me anë të kartelës së anëtarësisë. Po ashtu ka theksuar se paditësi ka ushtruar padi në gjykatë për realizimin e të drejtave pa përfunduar procedura administrative, sepse nuk i ka vazhduar procedurat në Inspektoratin e Punës në Prizren, që do të thotë se paditësi nuk i ka shterur të gjitha mjetet juridike në procedurën administrative, ashtu që i janë drejtuar gjykatës në kundërshtim me nenin 124 par. 6.1. të Ligjit për Procedurën Administrative, dhe me këto veprime të paditurës i shkaktojnë shpenzime të mëdha, sepse obligohen të paguajnë edhe shpenzimet e procedurës gjyqësore. Sa i përket obligimit lidhur me përmbushjen e detyrimit, e paditura në përgjigjen në padi thekson se vet Komuna e Prizrenit nuk është nënshkruese e Kontratës Kolektive, përkatësisht Qeveria e Republikës së Kosovës është garantues i implementimeve të KKAK-së, andaj Komuna e Prizrenit nuk ka kod buxhetor për përmbushjen e obligimeve që burojnë nga KKAK-ja. Në fund ka theksuar se e drejta për kompensim të kualifikimit për vitin 2017 dhe deri më 28.03.2022 është parashkruar, sipas nenit 353 të LMD-së. Me të gjitha të cekurat si më lartë, e paditura ka kërkuar që kërkesëpadia e paditësit të refuzohet në tërësi si e pabazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 399 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditëses është në tërësi e pa bazuar, andaj pa shqyrtim të çështjes, e refuzoi në tërësi kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ndërmjet palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se paditësja H.R. nga Prizreni ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura, si mësimdhënëse pranë SHFMU “Fadil Hisari” në Prizren në periudhën kohore 18.04.2017 deri me datën 23.04.2018, datë kur edhe ka dal në pension, kualifikimi i paditëses është e shkollës së lartë pedagogjike, respektivisht e njëjta ka të përfunduar Shkollën e lartë pedagogjike në Gjakovës, fakt i cili vërtetohet edhe nga diploma me numër 1248, e datës 18.11.2009, e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës – Fakulteti i Edukimit në emër të paditëses, ku e njëjta ka marrë titullin arsimtar i mësimi klasor dhe ka

licencë të karrierës. Bazuar në listën e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, vërtetohet se lartësia e pagës bazë të paditësit ka qenë në shumë prej 421 euro dhe se paditëses në emër të kualifikimit fakultet, në pagën bazë mujore i është paguar shuma prej 41.04 euro. Mirëpo, kontestuese ishte nëse paditëses i takon e drejta e kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, përkatësisht diferencës konkrete të papaguar si dhe nëse kërkesa e paditëses për kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit për këtë periudhë është parashkruar.

Gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditëses duhet të refuzohet në tërësi si e pabazuar, edhe atë në kuptim të nenit 399 paragrafi 1 të LPK-së, ku parashihet që *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadiës, atëherë ajo do të jep vendimin meritore me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”*, pasi që gjykata e vlerësoi të bazuar pretendimin e palës së paditur lidhur me parashkrimin e kërkesës së palës paditëse. Kështu, sipas nenit 87 të Ligjit të Punës shprehimisht theksohet që *“të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*. Në këtë drejtim, paditësja padinë pranë kësaj gjykate e ka parashtruar më datë 01.03.2022. Rrjedhimisht, duke vlerësuar afatin 3 vjeçar për parashkrimin e kërkesës në fjalë, gjykata erdhi në përfundim se paditëses ka mundur t’ia njoh të drejtën për kompensim nga data e paraqitjes së padisë 01.03.2022 deri me datën 01.03.2019, ndërsa paditësja kërkesën për kompensimin e ka bërë për periudhën 18.04.2017 deri më 23.04.2018. Në bazë të nenit 342 të LMD-së, ku parashihet që *“Parashkrimi fillon të rrjedhë ditën e parë pas ditës kur kreditori të ketë pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit, në qoftë se me ligj për raste të veçanta nuk është parashikuar diçka tjetër”*, rrjedhimisht këtu paditësja nga fillimi i çdo muaj pasues në të cilën e pa pranuar pagën ka pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit nga këtu e paditura, rrjedhimisht për pagën e fundit të muajt prill nga fillimi i muajt maj 2018 ka pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit nga këtu e paditura e që nënkupton se padia e paditëses për periudhën 18.04.2017 deri më datën 23.04.2018, është parashkruar, pasi që padia nuk është paraqitur brenda afatit të paraparë me nenin 87 të LP-së.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 450, 452 dhe 463 të LPK-së.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me nenin 143 lidhur me nenin 399 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL**  
2022:041277, 10.09.2024

**G j y q t a r i**  

---

**Baki Shigjeqi**

Numri i lëndës: 2022:041277  
Datë: 10.09.2024  
Numri i dokumentit: 06143841

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimi të të njëjtit, pranë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.